



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

**Përmbledhje e Vërejtjeve dhe Rekomandimeve**  
**ANALIZA E SHPENZIMEVE 2021-2023**

**KOMISIONERI PUBLIK**

**A. Lista e Programeve**

1. Veprimtaria e komisionerit publik.

**B. Komente të Përgjithshme**

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr 28., datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023", në mënyrë elektronike, dhe në hard copy.
2. Janë paraqitur të gjitha raportet e kërkesave buxhetore nga Institucioni në përputhje me pikën nr.5 të udhëzimit plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm nr.28, datë 10.07.2020.
3. Kërkesat buxhetore janë shoqëruar nga një relacion shpjegues në zbatim të përcaktimit të pikës 8(g) kapitulli 1, i udhëzimit nr.7/2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm".
4. Institucioni ka respektuar në total tavanin e alokuar.
5. Institucioni ka paraqitur kërkesa shtesë të cilat tejkalojnë tavanet përfundimtare të miratuara.
6. Formatet e dorëzuara janë firmosur nga Nëpunësi Autorizues.

**C. Analiza e Programit Buxhetor**

**Programi "Veprimtaria e komisionerit publik"**

**C.1 Formulimi i Qëllimit/Objektivave/Treguesve të Performacës**

- Formulimi i Qëllimit të Politikës së këtij programi dhe treguesi i performancës janë përcaktuar qartë.
- Është mirë-përcaktuar një objektiv dhe një tregues performance në nivel objektiv i cili është plotësuar me vlerat përkatëse.

- Janë evidentuar dhe kostuar politikat ekzistuese. Produktet e evidentuara janë kostuar plotësisht në përputhje përcaktimet e udhëzimit standard të Përgatitjes së PBA-së.
- Nga krahasimi i kostimit të politikave ekzistuese me tavanin buxhetor të alokuar për këtë institucion rezulton se:
  - ❖ Fondi i alokuar me tavanet buxhetore nuk ezauron plotësisht koston e politikave ekzistuese të këtij institucioni.

### **C.3 Kërkesat Buxhetore e Programit**

- Janë evidentuar dhe kostuar politikat ekzistuese. Nga krahasimi i kostimit të politikave ekzistuese me tavanin buxhetor të alokuar për këtë institucion rezulton se ka nevojë për financim shtesë.

Më konkretisht, sipas artikujve kërkesat shtesë për financim, për vitet 2021-2023 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

ZËRI	Kërkesa shtesë (në mijë Lekë)		
	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Shpenzime në paga	4,600	-	-
<b>Total</b>	<b>4,600</b>	-	-

- Për shpenzimet në paga, kërkesa vjen si pasojë e përlogaritjes së fondit të nevojshëm për të përballuar shpenzimet në paga.

### **D. Rekomandime**

- Për programin qëllimi dhe objektivi janë formuluar saktë, si dhe treguesit e performancës janë plotësuar me vlerat përkatëse.